

Ju ndryshon jetën dhe ju hap mendjen

## Erasmus+

Udhëzues për mundësitë  
e BE-së për arsimin,  
formimin profesional,  
rininë dhe sportin



Erasmus+

Erasmus+

***Europa Direkt është një shërbim, i cili ju ndihmon të gjeni përgjigjet e pyetjeve tuaja rreth Bashkimit European.***

**Numër telefoni falas nga vendet e BE-së (\*):**

**00 800 6 7 8 9 10 11**

(\* ) Informacioni i dhënë është falas sikurse edhe pjesa më e madhe e telefonatave (megjithatë nga disa operatorë, kabina telefonike ose hotele mund t'ju kushtojë).

Më shumë informacion rreth Bashkimit European mund të gjeni në Internet në adresën <http://europa.eu>.

Këtë broshurë në gjuhën shqipe dhe angleze mund ta gjeni në internet në:

[ec.Europa.eu/publications](http://ec.Europa.eu/publications)

<http://smei3.mie.gov.al/en/pages/Home>

<http://integrimi.gov.al/>

[www.rini.al](http://www.rini.al)

[www.sociale.gov.al](http://www.sociale.gov.al)

Luksemburg: Zyra e Botimeve e Bashkimit European, 2014

© Bashkimi European, 2014

Botimi në gjuhën shqipe u përgatit në kuadër të projektit të asistencës teknike SMEI 3 «Mbështetje për Procesin e Integritimit European – faza III», financuar nga Bashkimi European (IPA 2010).



Bashkimi European





**Nëpërmjet programit Erasmus+, Bashkimi European mbështet një gamë të gjerë aktiviteteve në fushat e arsimit, formimit profesional, rinisë dhe sportit. Kjo broshurë tregon mundësitë kryesore që jep ky program dhe shpjegon se ku mund të gjeni informacion të mëtejshëm për këto fusha.**

**Erasmus+**

# Përmbajtja

<b>Hyrje</b>	<b>4</b>
<b>Mbështetja e Erasmus+ për mobilitetin e të nxënit të individëve (Veprimi Kyç 1)</b>	<b>9</b>
Mobiliteti i nxënësit	10
Mobiliteti i stafit dhe punonjësve që punojnë me rininë	18
<b>Mbështetja e Erasmus+ për bashkëpunimin për risi dhe shkëmbimin e praktikave të mira (Veprimi Kyç 2)</b>	<b>21</b>
Partneritete Strategjike	22
Projekte bashkëpunimi të një shkalle të madhe	24
<b>Mjete në internet për shkollat dhe nxënien e të rriturve</b>	<b>30</b>
<b>Mbështetja e Erasmus+ për reformën e politikave të arsimit, formimit dhe rinisë (Veprimi Kyç 3)</b>	<b>33</b>
Iniciativat e ardhshme	34
Bashkëpunimi me shoqërinë civile	36
Dialog i strukturuar	38
<b>Mbështetje për sportin</b>	<b>40</b>
<b>Jean Monnet: mbështetje për studime dhe kërkime shkencore mbi Integrimin Europian</b>	<b>44</b>

# Hyrje

BE-ja po investon 14.7 miliard euro për Erasmus+, një program i ri për arsimin, formimin profesional, rininë dhe sportin për periudhën 2014-2020.

Erasmus+ është një program unik që synon të zgjerojë mundësitë për punësim dhe zhvillimin personal të të rinjve, si edhe të ndihmojë sistemet tona të arsimit, formimit dhe rinisë për një mësimdhënie dhe mësimnxënie që u siguron individëve aftësitë për të cilat kanë nevojë në tregun e sotëm të punës dhe në shoqëri, si edhe për të ardhmen.

Nëse jeni të interesuar për financimet e BE-së për arsimin, formimin, rininë apo sportin, atëherë kjo broshurë është për ju.

Në faqet e mëposhtme jepet informacion i rëndësishëm për mundësitë kryesore në këto fusha. Informacion më të detajuar gjeni në Udhërrëfyesin e Programit për kandidatët.

## Një program i integruar

Erasmus+ përfshin 3 Veprime Kyçe:

- Veprimi Kyç 1: Mundësi për mobilitet në të nxënë për studentët, kandidatët për doktoraturë, stazhierët, vullnetarët e rinj dhe të rinjtë në përgjithësi, si edhe për mësuesit, trajnuesit, lektorët dhe punonjësit që punojnë me të rinjtë.
- Veprimi kyç 2: Mundësia për të krijuar partneritete që nxisin bashkëpunimin brenda dhe ndërmjet institucioneve dhe organizatave të arsimit, formimit dhe rinisë, dhe midis botës së arsimit dhe punës.
- Veprimi Kyç 3: Mbështetje ndaj proceseve të reflektimit, dialogut dhe krijimit të provave të nevojshme për reformën në arsim, formim dhe në politikat e sistemet për të rinjtë.



## Mundësi për të gjithë

Erasmus+ ofron mundësi për:

- Studentët e arsimit të lartë dhe formimit profesional për të studiuar, për t'u formuar dhe për të marrë përvojë pune jashtë shtetit (duke përfshirë këtu mobilitetin në arsimin e lartë drejt Europës dhe nga Europa).
- Të rinjtë që të marrin pjesë në shkëmbime ndërkombëtare dhe aktivitete vullnetare (duke përfshirë drejt dhe nga Europa).
- Mësuesit, trajnuesit, lektorët, administratorët dhe punonjësit socialë që punojnë me rininë që të japin mësim, të trajtohen dhe të fitojnë përvoja të reja profesionale jashtë ose për të ndarë përvojën e tyre (përfshirë mobilitetin në arsimin e lartë drejt dhe nga Europa).
- Arsimin, formimin dhe për institucionet/organizatat e rinisë që të shkëmbejnë praktikat më të mira me qëllim që të sjellin risi dhe modernizim.
- Iniciativa bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe sipërmarrjeve për të forcuar potencialin sipërmarrës të studentëve dhe personelit, si edhe për të ndihmuar organizatat që t'u përgjigjen më mirë nevojave të tregut të punës.
- Mbështetje për të përmirësuar politikëbërjen dhe reformën e arsimit, formimit dhe sistemeve për të rinjtë.
- Projekte bashkëpunimi në fushën e sportit.






## Gjuhët për individët në lëvizje

Sa më të mira të jenë shprehitë tuaja gjuhësore, aq më shumë do të përfitoni gjatë qëndrimit tuaj jashtë. Praktikimi i gjuhëve të huaja është një aspekt i rëndësishëm i pjesës më të madhe të veprimeve të mobilitetit. Nëse jeni student në universitet, vullnetar apo anëtar i stafit me qëndrim jashtë shtetit për të paktën dy muaj ose nëse je student i shkollës profesionale me qëndrim jashtë shtetit për të paktën një muaj, Erasmus+ ju ofron mundësinë për të përforcuar njohuritë tuaja të gjuhës që do të përdorni për të studiuar, punuar apo për punë vullnetare.

Pasi të jetë miratuar aplikimi juaj për të udhëtuar, do të kërkohet që të bëhet një vlerësim i aftësive tuaja gjuhësore dhe do t'ju ofrohet një kurs gjuhe para se të niseni për jashtë shteti ose gjatë qëndrimit tuaj atje. Kontaktoni institucionet apo organizatën në vendin tuaj për të marrë më shumë informacion për këtë mundësi kaq të mirë që ju ofron Erasmus+. Përmirësoni shprehitë gjuhësore dhe bëhuni gati të udhëtoni!



# Erasmus+



## Mbështetja e Erasmus+ ndaj mobilitetit të të nxënës të individëve (Veprimi Kyç 1)

Erasmus+ mbështet një shumëllojshmëri mundësish mobiliteti për nxënësit dhe stafin e institucioneve dhe organizatave të arsimit, formimit dhe rinisë.

Për nxënësit, qëllimet e këtyre mundësive përfshijnë përmirësimin e performancës së mësimnxënies, rritjen e shanseve për punësim dhe përmirësimin e mundësive në karrierë, si edhe përmirësimin e zhvillimit të tyre personal dhe pjesëmarrjes në shoqëri.

Për personelin, qëllimet përfshijnë përmirësimin e kompetencave, rritjen e kapacitetit të tyre për të nxitur modernizimin në organizatat e tyre të arsimit dhe rinisë, dhe zgjerimim e njohurive për praktikat, politikat dhe sistemet.

# Mobiliteti i Studentit

## Studentët në arsimin e lartë

**Periudhat e studimit:** Studentët mund të kalojnë nga 3 deri në 12 muaj në një universitet apo kolegji në një shtet tjetër.

**Praktikat:** Nga ana tjetër ju mund të kryeni praktikën në një vend pune jashtë që mund të përfshijë një periudhë nga 2 deri në 12 muaj.

Studimi apo praktika mund të jetë në çdo fushë apo disiplinë akademike në nivelin Bachelor, Master apo Doktoraturë. Gjithashtu, është e mundur që të kombinoni periudhën e praktikës me periudhën e studimit jashtë.

Kohët e fundit, të diplomuarit e arsimit të lartë mund të kryejnë praktikën jashtë shtetit brenda një viti që nga diplomimi. Por planifikoni më parë! Duhet të përzgjidheni nga universiteti apo kolegji juaj gjatë vitit të fundit të studimit.

Erasmus+ gjithashtu mbështet disa studentë europianë të studiojnë në vende të tjera të botës dhe studentë nga vende të tjera të botës që të studiojnë në Europë.

## Për kë?

- Studentët ose kandidatët doktorantë që dëshirojnë të studiojnë apo trajnohen jashtë, ose të marrin një diplomë të përbashkët nga më shumë se një universitet
- Stazhierët ose praktikantët që kërkojnë të zgjerojnë aftësitë e tyre jashtë shtetit
- Të rinjtë që kanë dëshirë të përfitojnë nga shkëmbimet rinore dhe të bëjnë punë vullnetare jashtë

“ Studimet në një universtitet tjetër më ndihmuan që të zgjeroja horizontin në fushën time të studimeve, si asnjëherë më parë. Megjithatë pjesa më e bukur ishte fakti që takova shumë njerëz, me të cilët jam i sigurt që do të punoj në të ardhmen. ”

Roberti nga Anglia rreth përvojës së tij gjatë studimeve dhjetë-mujore për inxhinieri industriale në Universitetin Delft të Teknologjisë, në Holandë.



## Kreditë për studentët e Masterit

Erasmus+ mbështet kredi të reja, me kosto të ulët për të ndihmuar studentët e Masterit që të studiojnë në vende të tjera europiane, me kushte të favorshme kredi shlyerëse.

Studentët kanë mundësinë që të aplikojnë për kredi për studimet Master jashtë dhe mund të marrin hua deri më 12,000 euro për një kurs njëvjeçar ose deri në 18,000 euro për një kurs dyvjeçar.

Kreditë jepen nga ndërmjetës financiarë të caktuar në Vendet e Programit.

## Diploma të përbashkëta Masteri

Erasmus+ u ofron studentëve në të gjithë botën mundësinë e një burse për të frekuentuar programe studimi ndërkombëtare të përbashkëta të nivelit të lartë të drejtuara nga partneritetet universitare. Programet e Përbashkëta të Masterit të çojnë drejt një diplome të përbashkët të lëshuar nga disa ose të gjitha institucionet pjesëmarrëse.

### Këshillë!

Programet e përbashkëta të Doktoraturës mbështeten nga Veprimet Marie Skłodowska-Curie nën programin e Kërkimit Shkencor Horizont 2020. Programet e përbashkëta të Doktoraturës që janë në vazhdim të përzgjedhura nga Erasmus Mundus para vitit 2014 vazhdojnë të mbështeten nga Erasmus+.



## **Si të merrni më shumë informacion?**

**<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>**

## **Si të aplikoni?**

Ju mund të merrni më shumë informacion nga zyra ndërkombëtare e institucionit tuaj të arsimit të lartë. Në lidhje me diplomat e përbashkëta, studentët mund të gjejnë listën e diplomave të përbashkëta të Masterit në faqen e internetit të Agjencisë Ekzekutive për Arsimin, Klulturën dhe mjetet Audiovizuale (EACEA):

**<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>**

## Mobiliteti në trajnim dhe formim profesional (VET)

Mobiliteti jashtë mund të ndihmojë të rinjtë në trajnim dhe formim profesional që të përftojnë aftësitë e nevojshme për tregun aktual konkurrues të punës.

Studentët e arsimit të mesëm në shkollat e formimit profesional, stazhierët dhe praktikantët mund të përfundojnë stazhin ose praktikën jashtë, e cila mund të kryhet në një kompani, në një vend pune (p.sh. OJQ, organizatë publike) apo në një shkollë profesionale, së bashku me periudhën e mësimimit me bazë pune në një kompani. Praktikantët mund të zgjasin nga dy javë deri në një vit.

Gjithashtu, të diplomuarit e kohëve të fundit në një shkollë të arsimit profesional apo në një kompani (d.mth. praktikantët e mëparshëm) mund të marrin pjesë në një aktivitet mobiliteti. Të diplomuarit rishtazi duhet të kryejnë praktikën e tyre jashtë, brenda vitit të kualifikimit.

**“ Përvoja ime e mobilitetit sigurisht që më ka ndihmuar të përmirësoj karrierën time. Pa atë, unë nuk do të kisha besimin për të aplikuar tek konkursi Kuzhinieri i Ri i Vitit, pavarësisht nëse do të fitoja apo jo. Do ta rekomandoja për këdo. Udhëtimi im në Francë ka qenë dhe akoma deri më sot mbetet një nga kujtimet e mia më të mira. ”**

**Deborah** (MB) mbi përvojën e saj të praktikës së punës në Lion, Francë.





## **Si të merrni më shumë informacion?**

<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>

## **Si të aplikoni?**

Nëse jeni të interesuar për të aplikuar, duhet t'i drejtoheni institucionit tuaj të trajnimit dhe formimit profesional.

## Mobiliteti Rinor

**Shkëmbimet Rinore** ndihmojnë të rinjtë që të përftojnë aftësi të rëndësishme, si për shembull menaxhim projekti dhe punë në grupe. Mundësi të tilla jashtë mjedisit të shkollës bëjnë të mundur që grupet e të rinjve të ndërmarrin një program të strukturuar aktivitetesh (p.sh. një kombinim seminaresh, ushtrimesh, debatesh dhe lojë me role) në një vend tjetër brenda ose jashtë BE-së deri në 21 ditë.

**Shërbimi Vullnetar European** ofron një mundësi ideale për të rinjtë që të zhvillojnë aftësitë e tyre duke kontribuar në punën e përditshme të organizatave në fusha të tilla si kujdesi shoqëror, mjedisi, programe të arsimit jo-formal, TIK, kultura dhe shumë të tjera. Gjithashtu, kjo është një mundësi që ata të rriten me vetëbesim, të ndihen të angazhuar në mënyrë më aktive si qytetarë dhe të përjetojnë një mënyrë tjetër jete. Një aktivitet vullnetar mund të zgjasë deri në një vit dhe pjesëmarrësit mund të punojnë vullnetarisht për të mbështetur lloje të ndryshme çështjesh, brenda ose jashtë Bashkimit European.

Shkëmbimet Rinore janë të hapura për të rinjtë e moshës 13 dhe 30 vjeçare. Shërbimi Vullnetar European është i hapur për të rinjtë e moshës 17 deri në 30 vjeç.



**Vetëm brenda një viti me Shërbimin Vullnetar European, unë kam mësuar më shumë sesa kisha mësuar ndonjëherë më parë. Sigurisht që do ta rekomandoja Shërbimin Vullnetar për këdo që është mendjehapur dhe dëshiron të fitojë përvojë të re.**

**Klara** (Gjermani) për pjesëmarrjen në një projekt që ndihmon imigrantët e sapoardhur në Bruksel, Belgjikë, në qendrën e komunitetit Jozef Swinnen.



## Si të merrni më shumë informacion?

<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>

## Si të aplikoni?

Nëse jeni të interesuar për të aplikuar, duhet të lidheni me agjencinë kombëtare në vendin tuaj:

<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>



# Mobiliteti i stafit dhe i punonjësve socialë që punojnë me të rinjtë

Në rast se jeni mësues apo punoni në një sipërmarrje, ju mund të jepni mësim në një institucion jashtë, të fitoni këndvështrime të reja profesionale, të zgjeroni rrjetet tuaja dhe të ndihmoni në modernizimin dhe ndërkombëtarizimin e sistemeve të arsimit dhe formimit në Europë.

Mësuesit, stafi jo akademik apo punonjësit socialë që punojnë me të rinjtë mund të ndjekin kualifikime jashtë, si për shembull kurse të strukturuar, kualifikim gjuhësor me në qendër profesionin, aktivitete formimi dhe nxënieje në vendin e punës, për të zhvilluar njohuri dhe ide të reja që mund t'i vini në praktikë kur të ktheheni në vendin tuaj.

Këto aktivitete mund të zgjasin nga dy ditë deri në dy muaj.

## Si të merrni më shumë informacion?

<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>


## Si të aplikoni?

Nëse jeni të interesuar të aplikoni, duhet t'i drejtoheni institucionit/organizatës arsimore ose organizatës rinore ku punoni. Personeli i sipërmarrjes duhet të ftohet nga institucioni i arsimit të lartë ku ata synojnë të japin mësim.

### Për kë?

Stafi dhe punonjësit që punojnë me të rinjtë nga:

- Institucionet e arsimit të lartë (ose një sipërmarrje)
- Shkollat
- Organizatat e trajnimit dhe formimit profesional
- Organizatat e arsimit për të rritur
- Organizatat e të rinjve apo organizma të tjera aktiviste në fushën e rinisë



Në rast se dëshironi të krijoni dhe të ruani lidhje me mësues të shkollave të tjera apo me arsimtarë të kurseve online për të rriturit, atëherë mund t'ia vlejë të shihni me kujdes programet eTwinning (për mësuesit e shkollave) dhe EPAL (arsimtarë të kurseve për të rriturit). Për më shumë informacion, lexoni faqen 32 të kësaj broshure.

Në rast se punoni në fushën e Studimeve për Integrimin Europian, me interes për ju mund të jetë informacioni mbi programin Jean Monnet, në faqe 44.

**“ Mora përvojë duke parë vëzhguar punën që bëhej në Federatën e të Shurdhërve në Qipro., që të mësoja për punën dhe arritjet e tyre... Kjo më bëri ta kuptoja më mirë këtë kulturë, t'i zhvilloja më tej aftësitë e mia në gjuhën e shenjave dhe të kuptoja më mirë procesin e të nxënimit dhe zbatimin e tij kur jep mësim në klasa me nxënës të shurdhër. ”**

Kristof (Francë), mësues i gjuhës së shenjave, rreth përvojës së tij në Qipro.



Erasmus+

# Mbështetja e Erasmus+ për bashkëpunim për inovacionin dhe shkëmbimin e praktikave të mira (Veprimi Kyç 2)

Erasmus+ mbështet projektet e partneritetit për organizatat, institucionet, kompanitë dhe organizatat e kërkimit shkencor në fushat e arsimit, trajnimit dhe rinisë.

Këto projekte nxisin bashkëpunimin përtej kufijve dhe sektorëve, brenda dhe përtej fushave të arsimit, formimit, rinisë si edhe me botën e punës. Qëllimet e tyre përfshijnë përtëritjen dhe modernizmin e praktikave, forcimin e bashkëpunimit dhe transferimit të njohurive në nivel organizate, në nivel vendor, rajonal, kombëtar dhe europian. Në fushën e arsimit të lartë, ato mbulojnë edhe projektet e rritjes së kapaciteteve duke sjellë së bashku institucionet e arsimit të lartë të shteteve pjesëmarrëse në programi dhe shtetet partnere.

Duke u përfshirë në projekte partneriteti, organizatat pjesëmarrëse do të krijojnë mjedise më moderne, dinamike dhe profesionale, një kapacitet më të madh për të punuar në nivelin e BE-së/ndërkombëtar dhe qasje më inovative për t'iu përgjigjur grupeve të tyre të synuara.

# Partneritete Strategjike

## Brenda dhe përtej fushave të arsimit, formimit dhe rinisë, si dhe me botën e punës

Partneritetet Strategjike kanë për qëllim të zhvillojnë, transferojnë dhe zbatojnë praktika inovative të arsimit, formimit dhe rinisë nëpërmjet bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet organizatave të llojeve të ndryshme.

Për të arritur këto qëllime, Erasmus+ mbështet organizatat aktiviste në fushat e arsimit, formimit dhe rinisë nga vende të ndryshme. Projektet e mbështetura mund të angazhojnë organizata nga sektorë të ndryshëm ekonomik dhe shoqëror që punojnë së bashku nëpërmjet partneriteteve me sipërmarrjet, autoritetet publike dhe organizatat e shoqërisë civile.

Partneritetet Strategjike mund të ndryshojnë ndjeshëm, duke filluar nga projekte të thjeshta bashkëpunimi ndërmjet organizatave të një shkalle të vogël (si shkollat apo grupet joformale të të rinjve) e deri në projekte të një shkalle të madhe, të cilat kanë në qendër zhvillimin dhe shkëmbimin e rezultateve inovative në fushat e arsimit, formimit dhe rinisë.

Ato mund të trajtojnë një fushë të caktuar, por edhe kanë si qëllim të nxisin bashkëpunimin ndërmjet fushave të arsimit, formimit dhe rinisë dhe të vendosin lidhjet me botën e punës.

Llojet e aktiviteteve (listë jo-shteruese) që mund të mbështeten përfshijnë:

- Krijimin e programeve të përbashkëta studimi, kurrikula të reja, metoda të reja të mësimdhënies, (p.sh. shfrytëzim më i mirë i TIK), materiale të reja mësimdhënëse/trajnuese, metoda dhe praktika (p.sh për gjuhët), burime të hapura arsimore dhe shkëmbime virtuale mobiliteti.
- Formimin e rrjeteve dhe të nxënien me bashkëmoshatarët duke u mundësuar studentëve dhe stafit që të studiojnë çështje nga praktika me sipërmarrjet me qëllim zhvillimin e një mentaliteti sipërmarrës dhe të menduarin krijues.



- Shkëmbimi i praktikave të mira dhe risive për shërbimet mbështetëse si, orientim, këshillim dhe metoda trajnimi.
- Njohja e kompetencave të përftuara gjatë të nxënies joformale dhe informale në nivel kombëtar duke iu referuar kornizave të BE-së dhe duke përdorur instrumenta të dokumentacionit të BE-së.
- Bashkëpunim i strukturuar dhe afat-gjatë ndërmjet institucioneve dhe aktorëve (p.sh. sipërmarrjeve private, partnerëve social, autoriteteve vendore/rajonale, OJQ-të).
- Iniciativa ndërkombëtare që nxisin mentalitet dhe aftësi sipërmarrëse, për të inkurajuar qytetari aktive dhe sipërmarrje të reja sociale

Partneritetet Strategjike mund të organizojnë edhe aktivitete mobiliteti për studentët dhe stafin nëse ata mbështesin/plotësojnë aktivitetet e tjera të partneritetit dhe sjellin një vlerë të shtuar në përmbushjen e objektivave të projektit. Megjithatë, mobiliteti nuk është aktiviteti kryesor i Partneritetit Strategjik.

Partneritetet Strategjike mund të zgjasin për dy ose tre vjet në fushat e arsimit të lartë, VET, arsimit për të rritur dhe arsimit shkollor. Në fushën e rinisë, ato mund të zgjasin për një periudhë nga gjashtë muaj në dy vjet. Ato duhet të përfshijnë të paktën tre organizata në tre vende të ndryshme të programit, me disa përjashtime në fushat e rinisë dhe arsimit shkollor.

## Si të merrni më shumë informacion?

<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>

## Si të aplikoni?

Nëse përfaqësoni një organizatë arsimore, rinore apo ndonjë organizatë tjetër të interesuar, ju lutemi kontaktoni agjencinë kombëtare në vendin tuaj:

[http://ec.europa.eu/education/erasmus-plus/national-agencies\\_en.htm](http://ec.europa.eu/education/erasmus-plus/national-agencies_en.htm)

# Projekte bashkëpunimi të një shkalle të gjerë

## Aleancat e Njohurive: Bashkëpunim ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe sipërmarrjeve

Angazhimi i sipërmarrjeve është një mënyrë për të përmirësuar cilësinë dhe për t'i përshtatur më mire programet e arsimit të lartë me nevojat dhe realitetet e tregut të punës.

Për këtë qëllim, Erasmus+ financon Aleancat e Njohurive, të cilat janë partneritete të strukturuar që ndihmojnë në kapërcimin e hendekut ndërmjet botës akademike dhe asaj të punës, me qëllim që të stimulojnë inovacionin, si në arsimin e lartë, ashtu edhe në sipërmarrje.

Më tej, Aleancat e Njohurive ndihmojnë për të pajisur individët (studentët, stafin akademik dhe atë të kompanive) me më shumë aftësi dhe me një mentalitet të ri sipërmarrës duke i bërë kështu institucionet e arsimit të lartë dhe botën e biznesit më shumë sipërmarrëse dhe inovative, përfshirë këtu mjedisin shoqëror-ekonomik ku ato veprojnë.

Këto aleanca duhet të përfshijnë minimumi gjashtë organizata nga të paktën tre vende të ndryshme të programit, nga të cilat dy duhet të jenë partnerë sipërmarrës dhe dy të jenë partnerë akademikë.

Aleancat e Njohurive mund të mbështesin aktivitetet (listë jo-shteruese) që kanë si qëllim të:

- Zhvillojnë dhe zbatojnë metoda të reja të mësimnxënies dhe mësimdhënies (si p.sh. kurrikula të reja ndër-disiplimore, me në qendër studentin, dhe mësimdhënie e mësimnxënie të bazuara në probleme të vërteta).
- Organizojnë programe dhe aktivitete arsimore të vazhdueshme ndërmjet kompanive si dhe brenda tyre.

- Zhvillojnë zgjidhje të përbashkëta për çështjet sfiduese, për produktin dhe procesin e inovacionit (studentët, profesorët dhe profesionistët së bashku).
- Krijojnë struktura për të mësuar aftësi të ndërthurura si edhe zbatimin e tyre në të gjitha programet e arsimit të lartë. Këto duhet të zhvillohen në bashkëpunim me sipërmarrjet, e për rrjedhojë duke përfunduar mundësitë e punësimit, krijimtarisë dhe rrugëve të reja profesionale.
- Futjen e arsimit sipërmarrës në çdo disiplinë që t'u sigurojë studentëve, kërkuesve shkencorë dhe arsimtarëve njohuritë, aftësitë dhe motivimin për t'u angazhuar në aktivitete sipërmarrëse në një sere sektorësh.
- Hapjen e mundësive të reja të të nxënit nëpërmjet zbatimit praktik të aftësive sipërmarrëse, që mund të përfshijë dhe/ose të çojë në komercializimin e shërbimeve, produkteve dhe prototipeve të reja.

Alencat e Njohurive mund të organizojnë edhe aktivitetet e mobilitetit për studentët, kërkuesit shkencorë dhe stafin nëse ata mbështesin/plotësojnë aktivitetet e tjera që janë në përputhje me objektivat e projektit. Megjithatë, mobiliteti nuk është aktiviteti kryesor i Aleancës së Njohurive.

## Për kë?

Alencat e Njohurive janë për:

- Institucionet e Arsimit të Lartë
- Sipërmarrjet publike, private, të vogla, të mesme dhe të mëdha (përfshirë edhe sipërmarrjet shoqërore)
- Organizatat e përfshira në sistemet e trajnimit dhe formimit (autoritete publike dhe private) institucionet e kërkimit shkencor dhe OJQ-të



# Aleancat e Aftësive Sektoriale: Bashkëpunim ndërmjet ofruesve të VET dhe botës së punës

Aleancat e Aftësive Sektoriale janë projekte ndërkufitare me në qendër sfidat kombëtare dhe europiane në lidhje me aftësitë që u nevojiten punonjësve për t'u punësuar në sektorë të ndryshëm.

Ato duhet të përfshijnë të paktën nëntë organizata të ndryshme nga të paktën tre vende të programit, duke përfshirë dy Shtete Anëtare.

Aleancat e Aftësive Sektoriale mund të mbështesin aktivitetet (listë jo-shteruese) që kanë si qëllim të:

- Përcaktojnë aftësitë dhe nevojat e ofrimit të trajnimit në një sektor të caktuar ekonomik (p.sh. mbledhjen dhe interpretimin e fakteve për aftësitë që nevojiten në tregun e punës në një sektor të caktuar të ekonomisë).
- Hartimin e kurrikulave specifike të BE-së sipas sektorit, programe të VET-së dhe integrimin e qasjeve inovative në mësimdhënie dhe mësimnxënie, kryesisht nëpërmjet përdorimit më strategjik dhe të integruar të TIK dhe Burimeve të Hapura Arsimore. Duhet të krijohen edhe mundësi për të vënë në zbatim njohuritë në projekte praktike/"të jetës së vërtetë" në vendin e punës, së bashku me mundësinë për të krijuar mentalitete sipërmarrëse.

Aleancat e Aftësive Sektoriale mund të organizojnë edhe aktivitete mobiliteti për studentët dhe stafin nëse ato mbështesin/plotësojnë aktivitetet e tjera të Aleancës dhe sjellin një vlerë të shtuar në përmbushjen e objektivave të projektit. Megjithatë, mobiliteti nuk është aktiviteti kryesor i Aleancës së Aftësive Sektoriale.

## Për kë?

Aleancat e Aftësive Sektoriale janë për:

- Ofruesit e trajnimit dhe formimit profesional
- Organizatat me përvojë specifike brenda sektorit (p.sh. organizatat e punëmarrësve, federatat dhe dhomat e tregtisë)
- Organizatat e përfshira në sistemet e arsimit dhe formimit (si autoritetet publike ashtu edhe ato private), institucionet e kërkimit shkencor dhe OJQ-të



## **Ngritja e kapaciteteve në arsimin e lartë: Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë në vendet partnere**

Erasmus+ mbështet bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë të shteteve pjesëmarrëse në program dhe institucioneve homologe në botë. Institucionet partnere mund të zgjidhen nga shtetet e BE-së të Politikës së Fqinjësisë, shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe nga Rusia, si edhe nga shtetet e rajoneve të Azisë, Amerikës Latine, Afrikës/Karaibeve/ vendeve të Paqësorit.

Projektet duhet të kenë si qëllim zhvillimin dhe modernizimin e insitucioneve dhe sistemeve të arsimit të lartë në vendet partnere për të përmirësuar nivelin e aftësisë dhe shprehive. Gjithashtu, ato mund të riformësojnë sistemet arsimore duke përfshirë politikëbërës të arsimit në nivel kombëtar apo rajonal.

Shembuj të projekteve mund të përfshijnë:

- Projekte të përbashkëta që zhvillojnë kurrikula dhe diploma të reja, metodologji mësimnxënieje dhe mësimdhënieje, zhvillim të stafit, sigurimin e cilësisë, strukturën dhe procese të reja të qeverisjes dhe menaxhimit.
- Projekte për zhvillimin e reformave strukturore në nivel kombëtar me mbështetjen e autoriteteve në vendet partnere (p.sh. modernizimi i politikave, sistemet e qeverisjes dhe menaxhimit të arsimit të lartë).



# **Ngritja e kapaciteteve në fushën e rinisë: Bashkëpunim me organizatat rinore në shtetet partnere**

Erasmus+ mbështet projektet e bashkëpunimit ndërmjet organizatave aktiviste në fushën e rinisë në të gjithë botën. Këto projekte kanë si qëllim të përmirësojnë cilësinë dhe njohjen e punës së të rinjve, nxënien jo-formale dhe punën vullnetare në rajone të ndryshme të botës - kryesisht në vendet në zhvillim – dhe për të përmirësuar mënyrën se si ato plotësojnë sistemet zyrtare të arsimit, tregut të punës dhe shoqërisë.

Shembuj të aktiviteteve (listë jo shteruese) përfshijnë:

- Bashkëpunim, ngritjen e rrjeteve dhe nxënien ndërmjet bashkëmoshatarëve të organizatave rinore. Punën e përbashkët për ndërgjegjësimin dhe njohjen e punës vullnetare dhe nxënien jo-formale në shtetet partnere.
- Zhvillimin dhe zbatimin e praktikave dhe mjeteve të mira për zhvillimin profesional të trajnuesve dhe të punonjësve që punojnë me të rinjtë.
- Aktivitete gjithëpërfshirëse ndërmjet organizatave të sektorit të rinisë dhe komuniteteve vendore.
- Përvoja mësimore jashtë vendit për të rinjtë dhe zhvillimin e skemave të shkëmbimit ndërkufitar.
- Shkëmbime rinore, punë vullnetare jashtë shtetit dhe mobilitetin e punonjësve që merren me të rinjtë.

## **Si të merrni më shumë informacion?**

<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>

## **Si të aplikoni?**

Nëse përfaqësoni një organizatë të interesuar për Aleancat e Njohurive, Aleancat e Aftësive Sektoriale dhe partneritetet për të ngritur kapacitetet, për më shumë informacion vizitoni faqen e internetit të Agjencisë Ekzekutive për Arsimin, Klulturën dhe mjetet Audiovizuale (EACEA) në vendin tuaj:

<http://eacea.ec.europa.eu>

# Mjete në internet për shkollat dhe arsimin për të rritur

## Binjakëzimi elektronik (eTwinning)

Binjakëzimi elektronik, ose siç njihet ndryshe “e-Twinning”, mbështet dhe përforcon bashkëpunimin ndërmjet shkollave duke siguruar mbështetje, mjete të dobishme dhe një vend për të punuar së bashku në internet. E-Twinning mund të përdoret për të mbështetur projektet e mobilitetit, Partneritetet Strategjike apo për të bashkëpunuar në internet.

Për më tepër, e-Twinning kontribuon në zhvillimin profesional të mësuesve dhe stafit duke u ofruar materiale mësimi në internet dhe mundësi për të qenë pjesë e rrjeteve në të gjithë Europën.

Të gjitha shkollat dhe institucionet para-shkollore në shtetet pjesëmarrëse në program janë të mirëpritura që të përdorin e-Twinning në çdo kohë duke u regjistruar në portalin [www.etwinning.net](http://www.etwinning.net).

## EPALE (Platforma Elektronike për Nxënien e të Rriturve në Europë)

EPALE është një hapësirë në internet për të shkëmbyer, treguar dhe shpërndarë metodat e praktikave të mira në shkollimin e të rriturve. Ajo krijon komunitete të stafit të arsimit për të rritur në të gjithë Europën.

Platforma do të jetë e disponueshme në fund të vitit 2014.

“**Shumë studentë nuk do të udhëtojnë më për të parë jetën dhe kulturën e fqinjëve tanë europianë, prandaj është detyra jonë që ta sjellim botën e jashtme në shkollën tonë.**”

Ann (MB) Zv.Drejtoreshë e Shkollës Durham Trinity për fëmijët me nevoja të veçanta






**Si të merrni më shumë informacion?**

<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>



# Erasmus+



# Mbështetja e Erasmus+ për reformën e politikave të sistemeve të arsimit, formimit dhe rinisë (Veprimi Kyç 3)

Erasmus+ mbështet veprimet e politikave që kanë si qëllim të përmbushin objektivat e Strategjisë Europiane 2020, të kuadrit Strategjik për bashkëpunim europian në arsim dhe trajnim (ET 2020) dhe të Strategjisë Europiane të Rinisë.

Aktivitete në mbështetje të këtyre veprimeve përfshijnë iniciativa për zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave, rrjeteve dhe mjeteve për të nxitur dialogun dhe promovuar arsimin e lartë europian midis politikbërësve, aktorëve dhe vendeve partnere dhe takime ndërmjet të rinjve dhe vendimmarrësve në fushën e rinisë (Dialog i Strukturuar).

Rezultatet e synuara të këtij veprimi përfshijnë përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të sistemeve të arsimit, formimit dhe rinisë, për të promovuar të nxënë të reciprok dhe bashkëpunim ndërkombëtar, për të zhvilluar njohuritë dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të të rinjve në jetën demokratike.

# Mbështetje e Erasmus+ për reformën e politikave (Iniciativat e Ardhshme)

Erasmus+ siguron mundësi financimi për përmirësime strategjike ose të organizatave në sistemet e arsimit dhe formimit dhe në politikat për të rinjtë që fokusohen për aktorët kryesorë dhe autoriteteve publike.

## Projekte bashkëpunimi të avancuara

Projektet e bashkëpunimit të avancuara janë partneritete ndërmjet aktorëve kryesorë dhe njohurive më të fundit për të eksploruar qasje inovative për reformimin apo modernizimin e sistemeve ose politikave në fushat e arsimit, formimit dhe rinisë.

Ato mund të ofrojnë gjithashtu të dhëna të vlefshme për politikë-bërësit duke ndarë rezultatet e tyre ndërmjet aktorëve dhe nëpërmjet rrjeteve të aktorëve.

## Eksperimentimet e politikës europiane

Eksperimentimet e politikës europiane janë fusha eksperimentimi të drejtuar nga autoritete publike të nivelit të lartë në fushat e arsimit, formimit dhe rinisë, për të vlerësuar efikasitetin dhe shkallëzueshmërinë e politikave inovative nëpërmjet metodave rigorozë të vlerësimit.

## Si të merrni më shumë informacion?

<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>

## Si të aplikoni?

Nëse jeni të interesuar për të aplikuar duhet të kontaktoni me Agjencinë Ekzekutive për Arsimin, Kulturën dhe mjetet Audiovizuale (EACEA):

[http://ec.europa.eu/education/erasmus-plus/national-agencies\\_en.htm](http://ec.europa.eu/education/erasmus-plus/national-agencies_en.htm)



## Për kë?

- Institucionet kryesore të arsimit, formimit dhe rinisë apo organizata që dëshirojnë të hetojnë qasje të reja strategjike dhe për zhvillimet e politikave.
- Autoritete publike që kanë dëshirë të testojnë dhe vlerësojnë efkasitetin e politikave inovative përpara zbatimit në shkallë të gjerë.

# Mbështetje e Erasmus+ për reformën e politikave (bashkëpunimi me shoqërinë civile)

Erasmus+ siguron mundësi financimi për bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile në fushat e arsimit, formimit dhe rinisë, për ndërgjegjësimin e aktorëve të axhendave të politikës europiane në këto fusha dhe për të marrë angazhimin e tyre aktiv.

## Bashkëpunimi me shoqërinë civile

Erasmus+ mbështet organizatat e shoqërisë civile për të siguruar përfshirjen aktive të aktorëve në zbatimin e reformave të politikave në vende të ndryshme, për të promovuar pjesëmarrjen e tyre në Erasmus+ dhe në programe të tjera europiane, si edhe për shpërndarjen e rezultateve të politikave, programeve dhe praktikave më të mira nëpërmjet anëtarësimit të tyre të gjerë në rrjete.

## Si të merrni më shumë informacion?

<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>

## Si të aplikoni?

Organizatat jo-qeveritare europiane dhe rrjetet e zgjeruara europiane të interesuara për bashkëpunimin me shoqërinë civile janë të ftuara që t'i drejtojnë pyetje Agjencisë Ekzekutive për Arsimin, Kulturën dhe mjetet Audio-Vizuale (EACEA):

<http://eacea.ec.europa.eu>

A large, diverse group of people of various ages and ethnicities are smiling and looking towards the camera. The group is arranged in several rows, with some people in the foreground and others in the background. The overall mood is positive and inclusive.

## Për kë?

- Organizata joqeveritare europiane (në fushat e arsimit, formimit dhe rinisë)
- Rrjete të zgjeruara të BE-së (në fushat e arsimit, formimit dhe rinisë)

# Mbështetje e Erasmus+ për reformën e politikave (Dialog i strukturuar)

Erasmus+ siguron mundësi financimi për Dialogun e Strukturuar ndërmjet të rinjve dhe vendimmarrësve në fushën e rinisë.

## Dialogu i Strukturuar

Dialogu i Strukturuar promovon pjesëmarrjen aktive të të rinjve në jetën demokratike dhe inkurajon debatet që kanë në qendër temat dhe prioritetet e caktuara nga Dialogu i Strukturuar dhe Strategjia Europiane e Rinisë.

Projektet mund të marrin formën e takimeve, konferencave, konsultimeve dhe organizimeve. Aktivitetet që mund të marrin mbështetje përmenden më poshtë:

- Takimet kombëtare, seminarët ndërkombëtare dhe organizime që ofrojnë hapësira për informacion dhe debat me vendimmarrësit për të rinjtë për çështje që lidhje me Strategjinë Europiane të Rinisë.
- Dialog i Strukturuar që lidhet me aktivitet e organizuara gjatë Javës Europiane të Rinisë.
- Konsultime me të rinjtë për të mësuar nevojat e tyre për çështjet që lidhen me pjesëmarrjen në jetën demokratike.
- Aktivitete simuluese që paraqesin funksionimin e institucioneve demokratike dhe rolet e vendimmarrësve.





## Për kë?

- Organizata rinore që kanë dëshirë të marrin pjesë në Dialogun e Strukturuar me të rinjtë në nivelin e BE-së.

# Mbështetje për sportin

Erasmus+ mbështet partneritetet ndërkombëtare ndërmjet organizatave të sportit, federatave dhe organizmave qeverisëse për të promovuar sportin dhe aktivitetin fizik, veçanërisht në nivelin bazë. Programi trajton sfidat kryesore me të cilat përballet ky sektor, përfshirë dopingun, trukimin e ndeshjeve, racizmin dhe pabarazinë gjinore. Programi mund të ndihmojë edhe organizmat për të zhvilluar karrierë të dyfishtë për sportistët dhe të mbështesë zbatimin e udhëzimeve të BE-së mbi aktivitetin fizik që përmirëson shëndetin.

Shembuj të aktiviteteve përfshijnë:

- Ngritjen e rrjeteve ndërmjet aktorëve kryesore. Ndarja e njohurive teknike dhe praktikave të mira.
- Hartimi i udhëzimeve, rekomandimeve, kodeve të sjelljes/etikës dhe dokumenteve të tjerë të politikave.
- Bashkëpunim për hartimin dhe zbatimin e moduleve të stërvitjes dhe arsimit.

## Për kë?

- Organizma shtetëror përgjegjës për sportin në nivel vendor, rajonal ose kombëtar
- Klube sportive, organizata apo sindikata që përfaqësojnë sportistët
- Organizata që promovojnë aktivitetin fizik
- Organizata apo sindikata që përfaqësojnë profesionistët dhe vullnetarët në sport (p.sh. trajnerët, menaxherët)
- Organizatat aktiviste në fushën e arsimit, formimit apo rinisë



## Aktivite sportive europiane jo fitimprurëse

Programi Erasmus+ jep grante për organizata që ndihmojnë të financojnë aktivitetet sportive jo fitimprurëse, ku përfshihen disa shtete pjesëmarrëse.

Shembuj të këtyre aktiviteteve janë:

- Organizimi i aktiviteteve stërvitëse për sportistët, trajnerët, organizuesit dhe vullnetarët para aktivitetit sportiv.
- Organizimi i aktivitetit.
- Organizimi i aktiviteteve që shoqërojnë ngjarjen sportive (p.sh. konferenca, seminare).
- Realizimi i aktiviteteve pasuese (p.sh. vlerësime, hartimi i planeve të ardhshme).

## Si të merrni më shumë informacion?

<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>

## Si të aplikoni?

Aplikimet duhet t'i paraqiten Agjencisë Ekzekutive për Arsimin, Kulturën dhe mjetet Audio-Vizuale (EACEA):

<http://eacea.ec.europa.eu>



## Këshillë!

Ndryshe nga pjesët e tjera të programit këtu nuk ofrohet mbështetje për mobilitetin individual nëpërmjet granteve individuale. Megjithatë, organizatat sportive mund të aplikojnë për të financuar mobilitetin e sportistëve të rinj nën arsimin profesional dhe seksionin e programit për trajnimin.

# Jean Monnet: mbështetje për studime dhe kërkim shkencor për Integrimin European

Erasmus+ financon programin e veçantë “Jean Monnet” për mësimdhënie, kërkim shkencor dhe reflektim në fushën e studimeve të integritit europian.

Në fushën e studimeve europiane përfshihet analiza e zanafillës dhe evoluimit të Komuniteteve Europiane dhe të Bashkimit European (BE), duke pasqyruar dimensionin e brendshëm dhe të jashtëm të integritit europian, si edhe rolin e BE-së në dialogun mes popujve dhe kulturave të ndryshme, apo imazhin e BE-së në botë.

Programi financon mundësi në institucione të arsimit të lartë, në Europë dhe më tej. Individët nuk mund të aplikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, por përfitojnë nga aktivitetet e vetë institucioneve.

## Si të merrni më shumë informacion?

<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>

## Si të aplikoni?

Aplikimet duhet t'i paraqiten Agjencisë Ekzekutive për Arsimin, Kulturën dhe mjetet Audio-Vizuale (EACEA):

<http://eacea.ec.europa.eu>

“ **Bursa Jean Monnet në Qendrën Robert Shuman të Studimeve të Avancuara ishte një nga përvojat më të pasura profesionale dhe personale të jetës sime. Më dha mundësinë që të zhvilloja programin tim të kërkimit shkencor dhe të përfshiheja me komunitete akademike ndërkombëtare. Kjo përvojë do të jetë e rrënjosur përgjithnjë në kujtimet e mia.** ”

**Tamirace** (Liban), Jean Monnet Fellow 2010/2011  
Asistent Profesor, Universiteti American Libanez



## Për kë?

- Institucionet e Arsimit të lartë në BE ose në çdo vend tjetër të botës të interesuara ose që specializohen për Integrimin European
- Shoqata profesorësh që specializohen në studimet për Integrimin European
- Rrjetet e interesuara ose që specializohen në Integrimin European


# Vendet pjesëmarrëse

## Shtetet e programit

Shtetet e programit janë ato vende, të cilat marrin pjesë plotësisht në të gjitha mundësitë që ofron Erasmus+. Këtu përfshihen të gjitha Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian, si edhe shtetet e mëposhtme, në rast se kanë përmbushur kushtet e nevojshme: Islanda, Lihtenshtejni, Norvegjia, Zvicra, Turqia dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë.

## Shtetet Partnere

Të gjitha vendet e tjera të botës janë shtete partnere dhe mund të përfshihen në disa pjesë të programit, siç shpjegohet në Guidën e Programit.





## Programi Erasmus+

<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>

## Agjencitë Kombëtare

[http://ec.europa.eu/education/erasmus-plus/national-agencies\\_en.htm](http://ec.europa.eu/education/erasmus-plus/national-agencies_en.htm)

## Botimet

Libraria e BE-së: <http://bookshop.europa.eu>

## Botimet e Drejtorisë së Përgjithshme për Arsimin dhe Kulturën:

[http://ec.europa.eu/dgs/education\\_culture/publ/eac\\_en.html](http://ec.europa.eu/dgs/education_culture/publ/eac_en.html)

## Të bashkëbisedojmë në mediat sociale

Twitter: #ErasmusPlus

Facebook: Erasmus+

## Në Shqipëri

Ju mund të gjeni informacion dhe broshura mbi Bashkimin Europian në:

### Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri

ABA Business Center, Rr. Papa Cjon Pali II, kati 17, Tiranë, Shqipëri

Faqja e Internetit: [www.eeas.europa.eu/delegations/albania](http://www.eeas.europa.eu/delegations/albania)

Telefon: +355 (0)4 222 8320 ose 223 0871 – 222 8479 – 223 4284

Fax: +355 (0)4 223 0752

E-mail: [delegation-albania@eeas.europa.eu](mailto:delegation-albania@eeas.europa.eu)

### ndiq Delegacionin e BE në:

Portal: [www.eudalbania.eu](http://www.eudalbania.eu)

Facebook: [www.facebook.com/eu.delegation.albania](http://www.facebook.com/eu.delegation.albania)

Twitter: [www.twitter.com/eu\\_albania](http://www.twitter.com/eu_albania)

### Ministria e Integritit Europian

Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Sheshi Nënë Tereza, 1010

Tiranë, Shqipëri

Faqja e Internetit: <http://integrimi.gov.al>

E-mail: [info@integrimi.gov.al](mailto:info@integrimi.gov.al)

### Projekti i Mbështetjes së Proçesit të Integritit në BE (SMEI 3)

Ministria e Integritit

Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Sheshi Nënë Tereza, 1010

Tiranë, Shqipëri

Telefon: +355 (0)4 223 6790 / 6741

Faqja e Internetit: <http://smei3.mie.gov.al/en/pages/Home>

E-mail: [info@smei3.com](mailto:info@smei3.com)



## SI TË MERRNI BOTIMET E BE-së

### Botime falas:

#### një kopje:

- nëpërmjet Librarisë së BE-së (<http://bookshop.europa.eu>);

#### më shumë se një kopje apo postera/harta:

- nga përfaqësitë e Bashkimit Europian ([http://ec.europa.eu/represent\\_en.htm](http://ec.europa.eu/represent_en.htm));
- nga delegacionet e BE-së në shtetet jo anëtare ([http://eeas.europa.eu/delegations/index\\_en.htm](http://eeas.europa.eu/delegations/index_en.htm));
- duke kontaktuar shërbimin Europa Direkt ([http://europa.eu/europedirect/index\\_en.htm](http://europa.eu/europedirect/index_en.htm)) or duke marrë në telefon 00 800 6 7 8 9 10 11 (numër telefoni falas nga kudo në BE) (\*).

(\*Informacioni i dhënë është falas sikurse janë edhe pjesa më e madhe e telefonatave (megjithatë telefonatat mund të kushtojnë nga disa operatorë të caktuar telefonikë, kabina telefonike apo nga hotelet mund t'ju kushtojë)

### Botime me pagesë:

- nëpërmjet Librarisë së BE-së (<http://bookshop.europa.eu>).

### Abonime me pagesë:

- nëpërmjet një prej agjentëve të shitjes të Zyrës së Botimeve të Bashkimit Europian ([http://publications.europa.eu/others/agents/index\\_en.htm](http://publications.europa.eu/others/agents/index_en.htm)).

## Pika juaj e kontaktit:

